

VENDIM
Nr. 745, datë 20.12.2023

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 446, DATË 16.6.2005, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE
TË PALUAJTSHME, SHETETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË METROLOGJISË DHE
KALIBRIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 14, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 446, datë 16.6.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrit”, bëhen këto ndryshime:

a) Titulli i vendimit ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë”.

b) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë.”.

c) Në listën e inventarit që i bashkëlidhet vendimit, formulari për pronën, me emërtimin “DPMK dega Elbasan” zëvendësohet me formularin dhe planimetrinë që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

1. FORMULAR I PËRDITËSIMIT TË PRONËS

Identifikoi pronën: Olafsela Hosi
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar) Pepi Rila

Institucioni Qendror Shetetëror: **Ministria e Financave dhe Ekonomise**
Supervizoi: Perdrit Reme
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar) DBN

Institucioni i Varsise **Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë**
Aprovoi: Perdrit Reme
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)

Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emërtesa e pasurisë Adresa	Sip e pasurisë (m2)	Nga Sip.		funksioni per të cilin ndertese perdoret prona	Institucioni me perqiegjiesi administrative/ pronësi	Institucioni dorues i pasurive Statusi juridik i perdorimit	Inventarizuar me VKM	Te dhena te tjera (Shënime te vecanta)
						Truall (m2)	Ndertese (m2)					
1	ZK 8521	6/42-N.	Njesi	Objekti i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë (Peshë matjes) Elbasan	45	0	45	Administrative	Ministria e Financave dhe Ekonomise	Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë	VKM 446, 16.6.2005	

